



Drejtoria e Bujqësisë

THIRRJE PËR APLIKIM

Njoftohen të gjithë fermerët e Komunës së Prishtinës se mund të aplikojnë për përkrahje në lëmin e prodhimit organikë - bimë aromatike “Kopër”:

Kriteret :

- Përkrahen fermerët për mbjellje të sipërfaqes prej 0,50-1,00 ha;
- Përfituesi duhet të jetë banorë si edhe të ketë pronën në territorin e Komunës së Prishtinës;
- Fermerët janë të obliguar që ta bëjnë vet furnizimin me fidanë si edhe mbjelljen e tyre në sipërfaqen e planifikuar;
- Sipërfaqet e planifikuara për mbjellje më së paku tri vite nuk duhet të kenë qenë të mbjellura me kultura konvencionale;
- Rimbursimi i mjeteve nga ana e Komunës për fermerët do të bëhet pas konstatimit se janë përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara, si dhe varësisht nga sipërfaqet e mbjella me këtë kulturë ;
- Fermerët që mbjellin sipërfaqe më të madhe kanë përparësi në përzgjedhje;
- Fermerët duhet të furnizohen me farë nga entiteti i licencuar për prodhimin apo tregtimin e farërave të bimëve aromatike-mjekuese “Kopër” .
- Fermerët e përzgjedhurë janë të obliguar që të bëjnë analizën e tokës - parcelës që do e mbjellin me “Kopër” dhe nëse këto analiza tregojnë se ajo parcelë nuk i plotëson kriteret për kultivimin e kësaj kulture, atëherë përfituesi/ja , do të refuzohet;
- Duhet të investojnë në vendosjen e sistemit të ujitjes pikë – pikë;
- Të gjitha transaksionet-pagesat duhet të realizohen nëpërmes sistemit bankar.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirrollogarin bankare;
- Certifikata mbi pronësinë e paluejtshme me afat deri në një vit;
- Licencën e entitetit ku është bërë furnizimi me farë;
- Fatura;
- Certifikata e origjinës së farës;
- Certifikata fito-sanitare;
- Konfirmimi i transaksionit bankar.

Data e aplikimit, prej 30.03. deri 12.04.2017.